# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-459871**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Irani me dorë të hekurt/ Ekzekuton një person, dyshohej për spiunazh |
| ADRESA | `https://www.balkanweb.com/irani-me-dore-te-hekurt-ekzekuton-nje-person-dyshonte-se-spiunonte/` |
| BURIMI | balkanweb.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 20 shtator 2026, 12:03:11 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 20 shtator 2026, 06:30:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 20 shtator 2026, 06:29:00 UTC → 20 shtator 2026, 06:31:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `faf7da57efe401c51f0f6a593a497f74d71373ec727c5edeed0dd18e8e8d74d6` |
| TEKSTI | `a7b8ec5d25cdd8f5e07db33437d732fbb3867ed33486627f57cd2d09fe9acc98` |
| PAMJA | `e736c38b4441ef07da20b78b1ac9c948d98804bd4221ebfa7f5f97f01e617165` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `8510bd1d6a519f0be5e2523410cad34be85149eb81a4b700560c6b657d534fc4` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `36d3812b75abb32c2d0a144e9d997c17b4f1cdc4fe45cb80665e1d5362027ce4` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/8510bd1d6a519f0be5e2523410cad34be85149eb81a4b700560c6b657d534fc4`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Irani me dorë të hekurt/ Ekzekuton një person, dyshohej për spiunazh

20 Shtator, 2026 08:30



Madhësia e tekstit:

Irani ka ekzekutuar Hossein Pedaran, një shtetas iranian i dënuar për spiunazh dhe për dhënien e informacioneve të klasifikuara agjencisë të inteligjencës, Mossad. Ekzekutimi është konfirmuar nga Mizan, media e lidhur me Gjyqësorin iranian, e cila raportoi se dënimi me vdekje u zbatua pasi përfunduan të gjitha procedurat gjyqësore dhe vendimi u miratua nga Gjykata Supreme.

Sipas autoriteteve iraniane, Pedaran dyshohej se kishte bashkëpunuar me Mossad-in dhe i kishte përcjellë informacione të ndjeshme lidhur me objekte ushtarake dhe raketore në Isfahan. Në informacionet që, sipas Gjyqësorit iranian, ai kishte dorëzuar te shërbimi izraelit përfshiheshin të dhëna për aktivitetet raketore, objektet ushtarake, si dhe identitetet dhe të dhënat personale të disa pjesëtarëve të personelit.

Mizan raportoi se Pedaran fillimisht kishte tentuar të kontaktonte me Agjencinë Qendrore të Inteligjencës amerikane, CIA, me qëllim bashkëpunimin, por nuk kishte marrë përgjigje. Më pas, sipas versionit të autoriteteve iraniane, ai kishte vendosur kontakt me Mossad-in dhe kishte nisur bashkëpunimin me agjencinë izraelite.

Gjyqësori iranian pretendon se Pedaran ishte trajnuar nga një oficer i

BW Download on the App Store GET IT ON Google Play

Kerko ketu

LAJMET E FUNDIT


VIDEO/ "Buzëqesh" Dinamo, thyen Laçin
19 Shtator, 2026


VIDEO/ 4 gola në supersfidën e Serie A, Inter dhe Roma bëjnë paqe
19 Shtator, 2026


VIDEO/ Kampionët e Anglisë bien ndaj Brighton, disfatë e hidhur për Arsenalin
19 Shtator, 2026


"Mbështetje të plotë nga SHBA"/ Berisha: Lufta kundër narkoshtetit dhe trafiqeve, në fokus të takimeve tona
19 Shtator, 2026


Akuzohen se regjistruan një sipërfaqe toke në emër të biznesmenit, dalin para gjykatës dy ish-drejtuesit e ASHK-së së Fierit, specialisti dhe përfituesi
19 Shtator, 2026


"E kanë në dorë kryeministrin"/ Berisha: Balluku, Agasi e Beqiri janë "padronët në krim". Çfarë i tha Lubia në takim Ramës kur SPAK kërkoi arrestimin e saj
19 Shtator, 2026

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE
@balkanweb

Mossad-it për mënyrën e dërgimit të raporteve dhe përdorimin e komunikimeve të enkriptuara. Sipas Mizan, ai kishte marrë gjithashtu disa pagesa në euro për informacionet që kishte përcjellë.

Gjatë kontrollit në banesën e tij, autoritetet iraniane thanë se kishin gjetur një bllok shënimesh që përmbante informacione "shumë konfidenciale" lidhur me çështje raketore. Gjithashtu, sipas tyre, u sekuestruan disa pajisje për ruajtjen e të dhënave të enkriptuara dhe një pajisje e aftë për të fotografuar dhe regjistruar video në mënyrë të fshehtë.

Autoritetet iraniane kanë deklaruar gjithashtu se disa prej objekteve ushtarake për të cilat Pedaran dyshohet se i kishte dhënë informacione Mossad-it u goditën gjatë luftës 12-ditore. Sipas Gjyqësorit iranian, sulmet shkaktuan viktima dhe të plagosur mes punonjësve të këtyre objekteve.

Ekzekutimi i Pedaran është njoftuar nga autoritetet iraniane në një periudhë tensionesh të larta me Izraelin. Gjyqësori iranian ka akuzuar në raste të ndryshme persona për bashkëpunim me shërbimet izraelite të inteligjencës.

**© BalkanWeb**

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

**Etiketa:** ekzekutimi irani

### TË NGJASHME



**Dhoma e Përfaqësuesve i kërkon Trumpit t'i japë fund luftës në Iran, 7 republikanë votojnë pro**
16 Shtator, 2026



**Teherani krijon një portal online "ankesash" për kritikët e regjimit jashtë vendit**
15 Shtator, 2026

### TË FUNDIT NGA BOTA



**Zgjedhjet lokale trondisin Merz-in, CDU rrezikon humbje të madhe**
20 Shtator, 2026



**Ish-drejtori i CIA-s publikon shifrat tronditëse: 1.2 milionë ushtarë rusë të vrarë ose të plagosur në Ukrainë**
20 Shtator, 2026



**Përshkallëzohet konflikti/ Houthit godasin sërish Arabinë Saudite me drone, Jemeni në kaos total**
20 Shtator, 2026



**Po hetonte korrupsionin brenda strukturave të policisë, ekzekutohet gazetarja në Peru**
20 Shtator, 2026



**Kryeministri i Sllovakisë: Disa politikanë perëndimorë po kërkojnë konflikt mes NATO-s dhe Rusisë**
20 Shtator, 2026



**Dronë dhe raketa/ Nuk ndalen sulmet mes Rusisë e Ukrainës. Goditet Moska, vdesin 2 persona**
20 Shtator, 2026

### KATEGORIA VIDEO



**VIDEO/ "Buzëqesh" Dinamo, thyen Laçin**
19 Shtator, 2026



**VIDEO/ 4 gola në supersfidën e Serie A, Inter dhe Roma bëjnë paqe**
19 Shtator, 2026



**VIDEO/ Kampionët e Anglisë bien ndaj Brighton, disfatë e hidhur për**



**"Mbështetje të plotë nga SHBA"/ Berisha: Lufta kundër narkoshtetit**



**Arsenalin**

19 Shtator, 2026



**dhe trafiqeve, në fokus të takimeve tona**

19 Shtator, 2026



**Akuzohen se regjistruan një sipërfaqe toke në emër të biznesmenit, dalin para gjykatës dy ish-drejtuesit e ASHK-së së Fierit, specialisti dhe përfituesi**

19 Shtator, 2026



**"E kanë në dorë kryeministrin"/ Berisha: Balluku, Agasi e Beqiri janë "padronët në krim". Çfarë i tha Lubia në takim Ramës kur SPAK kërkoi arrestimin e saj**

19 Shtator, 2026



© 2026 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.